



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 494 Prot.

Tiranë, më dt. 07.12.2017

**VENDIM**

**Nr. 361, dt. 07.12.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.12.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Rikonstrukcion i rrugicës "Hito Lekdushi" në lagjen “Dunavat i I-rë” Gjirokastër”, me kërkesë të Bashkisë Gjirokastër.
  2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas pikës 5, neni 17, të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

Mirela Kumbaro Furxhi

**SEKRETAR I KKR**

Arta Dollani